



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 70/2 Prot.

Tiranë, më 26/12/2011

**Lënda:** Rekomandim për Banka “Credins” Tiranë.

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Banka “Credins” Tiranë.

**KONSTATOVA**

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Banka “Credins” Tiranë me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë, punonjës etj)
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara nga
- nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen ( neni 21 ).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale ( neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi Proces-Verbalin mbi shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit mbi këto shkelje si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi Banka “Credins” mbledh dhe përpunon të dhëna personale sensitive lidhur me **gjendjen gjyqësore**, për të gjithë anëtarët e familjes të punonjësit.

Mbledhja e këtyre të dhënave është e tepërt dhe jo proporcionale lidhur me qëllimin për të cilin ato mblidhen dhe përpunohen, duke qenë kështu në kundërshtim me nenin 5 pika 1 “c” ku thuhet “...*të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*”.

Komisioneri vlerëson se gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale kontrolluesi duhet të respektojë dhe të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të individit

dhe veçanërisht të drejtën e ruajtjes së jetës private. Mbledhja e të dhënës gjyqësore për të afërmit e punonjësit nuk ka asnjë lidhje me punonjësin dhe marrëdhënien e punësimit ndërmjet tij dhe punëdhënësit. Të dhënat personale të familjarëve nuk mund të jenë objekt i përpunimit nga ky kontrollues, pasi dalin tërësisht jashtë qëllimit për të cilin ato janë mbledhur.

Të dhënat personale të familjarëve, aq më pak e dhëna sensitive “*gjendja gjyqësore*”, nuk mund të merret në konsideratë nga punëdhënësi për vlerësimin e figurës dhe aftësiwe profesionale të punëkërkuësit apo punëmarrësit në punë. Vlerësojmë dhe çmojmë se mbledhja dhe përpunimi i këtyre të dhënave është **një ndërhyrje e rëndë** në privatësinë e individit (familjarëve të punonjësit) duke qenë kështu në kundërshtim të hapur me të drejtat themelore të individit, të saksionuara në Kushtetutën e Republikës (neni 35), Deklaratën Universale të të drejtave të Njëriut, Konventën e Këshillit të Evropës “Për mbrotjen e të drejtave të njëriut” (neni 8) dhe haptazi në kundërshtim me parimet e sanksionuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

2. Kontrolluesi Banka “Credins” mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë “punonjës”. Në formularin e njoftimit të plotësuar nga ana e këtij kontrolluesi pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale, nuk është deklaruar mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për këtë kategori subjektsh të të dhënave personale.

Mosdeklarimi i mbledhjes përpunimit të të dhënave personale për kategorinë “punonjës” në formularin e njoftimit të depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga ana e kontrolluesit Banka “Credins” është në kundërshtim me nenin 21 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas të cilit “*Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*”.

Bazur në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Gjithashtu, fakti që bëria publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shak të mos njoftimit të këtij përpunimi për kategorinë “punonjës”, mund të ketë penguar referencat e mundshme që klientë specifik mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit për kategorinë që ata i përkasin (punonjës).

Sigurisht, që edhe për aplikantë të ndryshëm për tu punësuar parnë kësaj banke ju është mohuar e drejta e informimit nëpërmjet Regjistrit të përpunimeve dhe nuk mund të jemi të sigurtë nëse ata janë informuar nga vetë kontrolluesi për këtë përpunim në momentin e aplikimit dhe si pasojë nëpunësve të punësuar gjatë kësaj periudhe nuk i është krijuar mundësia e ezaurimit të të drejtave të tyre.

3. Kontrolluesi Banka “Credins” mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera CCTV, jashtë ambienteve të kontrolluesit, duke monitoruar dhe pjesën e trotuarit dhe rrugës ngjitur me godinën e tij, për kalimtarë të rastësishëm të cilët nuk janë subjekt i qëllimit të këtij përpunimi.

Komisioneri vlerëson shkelje të nenit 5 pika 1 germa "c" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, përmes përdorimit të sistemit me kamera CCTV në ambientet e jashtme, (trotuar, rrugë) ngjitur me godinën e tij.

Mbledhja e të dhënave personale (imazhet) të kalimtarëve të cilët nuk kanë lidhje me këtë kontrollues, është e tepërt lidhur me qëllimin për të cilin kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale (imazhe) nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV, duke qenë kështu në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" nenin 5 pika 1 germa "c" ..*të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*".
- Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*"
- Rregulloren "*Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare*" (neni 10 pika "a"), miratuar me Vendimin Nr. 04, datë 19/01/2011 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Pa qenë subjekte të këtij përpunimi kalimtarët e rastësishëm automatikisht bëhet pjesë e këtij përpunimi i cili nuk ka për qëllim këtë kategori subjektësh. Ky lloj përpunimi cilësohet si ndërhyrje në jetën private të kalimtarëve, imazhet e të cilëve mund të përdoren në mënyrë abuzive për qëllime të tjera. Vëzhgimi i fasadës është mëse i mjaftueshëm nëse subjekti nga kalimtar i rastësishëm vendos të ndërmarrë sulme ndaj godinës, ambjenteve dhe territorit të kontrolluesit. Këto imazhe, sëbashku me imazhet e përpunuara nga CCTV në ambientet e brendshme janë mëse të mjaftueshme për të zhvilluar hetime në lidhje me identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimeve që dëmtojnë kontrolluesin.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

### REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale":
  - Ndalimin e menjëhershëm të mbledhjes dhe përpunimit të dhënave personale sensitive lidhur me gjendjen gjyqësore, për anëtarët e familjes të punonjësve.
  - Shkatërrimin nga arkivat fizike dhe elektronike, të të dhënave personale sensitive lidhur me gjendjen gjyqësore të mbledhura për anëtarët e familjes të punonjësve, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditëve.
2. Në zbatim të nenit 21, pika 1 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të deklarohej në formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategorinë "*punonjës*", brenda një afati prej 5 (pesë) ditëve.
3. Në zbatim të nenit 5, pika 1, germa "c" të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, të nenit 10, pika “a” të Rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”,

- Ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditëve.
- Shkatërrimin e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtroni veprimtarinë bankare dhe financiare brenda një afati prej 5 (pesë) ditëve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

